

Nga ferma deri në tryezë

Ushqim i sigurtë për konsumatorët e Europës



Këtë broshurë dhe sqarime të tjera mbi UE mund t'i gjeni në:
europa.eu.int/comm/publications

Komisioni Europian
Drejtoria e përgjithshme për botim dhe komunikime
Botime
B-1049 Bruksel

Dorëshkrimi u përfundua në korrik 2004

Ilustrimi i kopertinës: LWA-Stephen Welstead/Van Parys Media

Të dhënat e katalogjizimit janë të shënuara në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra e botimeve zyrtare të Komunitetit Europian, 2004

ISBN 978-92-79-04819-7

Komunitetet Europiane, 2004

Riprodhimi është i lejuar.

Shtypur në ish Republikën jugosllave të Maqedonisë

Nga ferma deri në tryezë

Ushqim i sigurtë për konsumatorët e Europës



Përmbajtja

Strategjia: nga ferma deri në tryezë	3
Ushqimi i shëndoshë: përmbledhje gjithpërfshirëse e standardeve	5
Vlerësimi i rrezikut: shkenca e shëndoshë për një politikë moderne	9
Mbrojtja e konsumatorëve: zbatimi dhe kontrolli	13
Informimi i konsumatorëve: etiketat pasqyrojnë sigurinë	14
Siguria e ushqimit fillon në fermat tona	17
Ushqimi i shëndoshë nga mbarë bota	19
Përtej sigurisë: kualiteti dhe shumëllojshmëria	20
Baza e shëndoshë e laramanisë dhe përsosmërisë	21
Literaturë plotësuese	22

Strategjia: nga ferma deri në tryezë

Konsumatorët e Europës duan ushqim të sigurtë dhe të shëndetshëm. Detyra e Unionit European është të sigurojë se ushqimin që e konsumojmë është i kualitetit të njejtë për të gjithë qytetarët e vet, qoftë ky ushqim i prodhuar në shtëpi ose në ndonjë vend tjetër, mbrenda ose jashtë UE-së.

Aktivitetet e përmirësimit të sigurisë së ushqimit janë në vazhdimësi, mirëpo krahas kësaj, gjatë disa viteve të fundit ka pasur kontroll të përgjithshëm. Ky veprim konsiderohet si përgjigje e kritikës së gazetave mbi panikën e sigurisë së ushqimit në vitet '90, siç ishte sëmundja e 'lopëve të çmendura', ushqimi i infektuar me substancë kimike dhe vaji i falsifikuar i ullirit. Përveç garancës se ligjet e UE për sigurinë e ushqimit janë të azhuruara maksimalisht, qëllimi është

që konsumatorët të informohen sa më tepër mbi rreziqet potenciale dhe masat që merren për t'i minimizuar këto rreziqe.

Reziku ineksiztent nuk mund të ekzistojë, mirëpo UE përpiket që me anë të një strategjie gjithpërfshirëse të sigurisë së ushqimit t'i zvogëlojë rreziqet deri në minimum. Këtë e bën me ndihmën e ushqimit modern dhe standardeve higjienike të hartuara për të pasqyruar njohurinë më të përparuar shkencore. Siguria e ushqimit fillon në fermë. Rregullat zbatohen duke filluar nga ferma dhe mbarojnë te piruni, pa marrë parasysh se a prodhohet ushqimi ynë në UE apo importohet nga ndonjë vend tjetër botëror.

Regjistrimi i kafshëve na ndihmon të ndjekim gjurmët e ushqimit prej në fermë deri në tryezë



Ekzistojnë katër elemente të rëndësishme të strategjisë së UE për sigurinë e ushqimit:

- rregullat mbi sigurinë e ushqimit të njerëzve dhe të kafshëve;
- këshillat shkencore të pavarura dhe publike;
- aktivitetet e zbatimit të rregullave dhe kontrollit të proceseve;
- njohja e të drejtës së konsumatorit, e bazuar në informatat e plota mbi origjinën dhe përmbajtjen e ushqimit.

Hapësirë për llojlojshmëri

Siguria e ushqimit nuk nënkupton edhe njëtrajtshmërinë e tij. Sistemi i garantimit të sigurisë së ushqimit është i përbashkët për të gjitha shtetet e UE, por natyrisht lejon laramani. Ekziston hapësirë edhe për ushqimet tradicionale dhe specialitetet lokale. Madje, Unioni Europian vazhdimisht promovon shumëllojshmërinë dhe kualitetin. Ushqimet e dalluara ose tradicionale që korrespondojnë me rajone ose metoda të caktuara të prodhimit, Unioni i mbron nga kopijimi i padrejtë dhe përveç kësaj promovon bujqësinë organike.

Atëherë kur bashkohen anëtarët e rinj

Në kohën kur një vend përgaditet për bashkim në UE, shpesh ndodh që ky vend të bëjë përpjekje të mëdha dhe të shtrenjta për harmonizimin e rregullave dhe modernizimin e objekteve të përpunimit dhe tregëtimit. Këto vende shpesh pranojnë ndihma financiare nga UE për ndryshimet e nevojshme. Në raste të jashtëzakonshme, UE mund të lejojë një periudhë tranzicionale për përfundimin e modernizimit, pas bashkimit të shtetit në fjalë me Unionin. Prandaj përjashtimet — kryesisht për uzinat e përpunimit të mishit dhe peshqve — aktualisht janë duke u zbatuar në Republikën Çeke, Letoni, Lituanit, Hungari, Poloni dhe Sllovakia.

Afati i fundit i përfundimit të këtyre detyrave është dhjetori i vitit 2007. Ndërkaq, ushqimi i fabrikave që edhe më tej duhet të përfundojnë modernizimin e tyre, mund të shitet vetëm në vendin ku është prodhuar ky ushqim. Konsumatorët e këtij vendi mund t'i dallojnë këto prodhime me lehtësi përmes vulës e cila dëshmon se këto prodhohen në objekte që akoma nuk përputhen me rregullat e UE.

Ushqimi i shëndoshë: rregullore gjithpërfshirëse

Rregullat e para mbi sigurinë e ushqimit janë të kohës së hershme të ekzistimit të UE. Kriza e sigurisë së ushqimit në vitin 1990 vërtetoi se ishte koha që rregullorja e vjetër përplot me rregulla të arnuara, të zëvendësohej me një më të thjeshtë dhe tërësore. Qasja e re i kushtonte vëmendje më të rëndësishme rrezeve nga ushqimi i infektuar.

Si rezultat u hartua pjesa e legjislacionit 'ombrellë' e njohur si Ligji i përgjithshëm i ushqimit, i cili u zbatua në periudhën mes 2002 dhe 2005. Ligji përcakton parimet që vlejné për sigurinë e ushqimit, por jo vetëm atë:

- Ai gjithashtu prezantoi konceptin e 'ndjekjes'. Me fjalë të tjera, bizneset e ushqimit — qofshin ato biznese të prodhuesve, përpunuesve apo importuesve — duhet të garantojnë se të gjithë artikujt ushqimorë, ushqimi i kafshëve dhe përmbajtja e këtyre ushqimeve mund të ndiqet pikërisht përmes zinxhirit ushqimor, nga ferma deri në pirun. Çdo biznes duhet të mund të identifikojë furnizuesin e vet dhe bizneset që i furnizon. Kjo njihet si qasja 'një hap prapa, një hap përpara'.
- Ai themeloi Autoritetin e sigurisë së ushqimit të Europës (EFSA). Ky institucion sjell nën kulmin e njejtë punën që më parë e kryenin një varg komitete shkencore dhe bën më transparent procesin e vlerësimit të rrezikut.

- Ai gjithashtu përforcon sistemin e shpejtë alarmues, të cilin e përdorin Komisioni Europian dhe qeveritë e UE për veprim urgjent në rast të panikës për sigurinë e ushqimit të njerëzve dhe/ose ushqimit të kafshëve.



Duam që ushqimi për fëmijët tanë të jetë i shëndetshëm.

Prodhuesit dhe përpunuesit doemos duhet t'u përmbahen një numri të madh të rregullave mbi çështje të veçanta. Qëllimi i të gjitha këtyre rregullave është të garantojnë sigurinë e ushqimit në bazë të mundësive teknike, vazhdimisht t'i informojnë konsumatorët dhe t'u ofrojnë sa më tepër zgjidhje.

Varësisht nga problemi, mund të nënkuptohet se UE miraton një pako të vetme të standardeve ose shtetet anëtare pajtohen me reciprocitetin e njohjes së standardeve të njeri tjetrit. Dallimet e vogla mund të jenë të parëndësishme nëse rezultati përfundimtar është i njëjtë.

Standardet e ushqimit të njerëzve dhe të kafshëve

Kujdes i veçantë i kushtohet elementeve që mund të përbëjnë ushqimin tonë në kohën e pjekjes ose prodhimit, dhe në kohën e përpunimit. Ky proces fillon me ushqimin e kafshëve, që nënkupton më çka janë ushqyer kafshët e fermave, të cilat prodhojnë (ose përbëjnë) ushqimin tonë.

Alarmet ushqimore të dekadës së fundit kanë nëvizuar rreziqet e kontaminimit nga lloje të caktuara të ushqimit të kafshëve, sidomos ato që përdoren në bujqësinë dhe blegtorinë e vrullshme. Si pasojë e kësaj, hartimi i politikës së UE tani vendos theksin vendimtar mbi mbrojtjen e shëndetit të njerëzve

dhe të kafshëve. Është ndaluar shitja e materialeve ushqimore për kafshë, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, e madje edhe për mjedisin. Etiketat duhet të tregojnë qartë atë që blen bujku.

Ngjashëm, shtesat kimike janë të ndaluara përveç në rastet kur miratohen për përdorim në ushqim. Miratimi nënkupton së pari kalimin e vlerësimit gjithpërfshirës nga Autoriteti Europian për sigurinë e ushqimit (EFSA). Mirëpo, megjithëse EFSA ka vërtetuar sigurinë, kjo nuk do të thotë se mund të garantohet drita e gjelbërt. UE jep shenjën për të vazhduar, vetëm nëse është bindur se shtesat shërbejnë për qëllime të dobishme dhe përdorimi i tyre nuk do të dezorientojë konsumatorët.

Për shtesat e ushqimit, siç janë ngjyrërat, ëmbëlsuesit, emulsifikatorët, stabilizuesit, trashësit dhe faktorët e mpiksjes vlejnjë rregulla të tjera. Për sasitë e mineraleve dhe vitamineve në shtojcat ushqimore, kufijtë e koncentratit të mineraleve të ujit në shishe, dhe përbërjen e ushqimeve speciale Rregulla të tjera zbatohen. Këto përfshijnë ushqimin e foshnjeve dhe ushqimin për zbritjen e peshës; ushqimin për qëllime të veçanta mjekësore dhe ushqimin e atletëve. Rregullat e këtilla jo vetëm që përcaktojnë përbërjen e ushqimeve në fjalë, por gjithashtu edhe sqarimet e etiketës mbi elementet përbërëse.

Për t'iu shmangur rreziqeve të shëndetit publik, UE është rigjide kur bëhet fjalë për sasinë e pesticideve dhe për tepricat e medicinës veterinarike, të cilat mbeten në ushqim në stadin e nxjerrjes në treg për konsumatorin. Përdorimi i hormoneve që nxisin zhvillimin e kafshëve është i ndaluar.

Krahas kësaj, ekzistojnë standarde për materialet që kanë të bëjnë me artikujt ushqimorë, sidomos plastikën, të cilat garantojnë se materialet e caktuara nuk e kontaminojnë ushqimin. Rregullat e UE lejojnë rrezatimin e bimëve barishtore dhe erëzave për të garantuar sigurinë mikrobiologjike. Disa shtete anëtare lejojnë rrezatimin e disa llojeve të tjera të ushqimit në mënyrë që të shtojnë afatin e ruajtjes së prodhimit ose të zvogëlojnë rreziqet shëndetësore. Përdorimi i teknikës është i sistemuar me saktësi dhe sidoqoftë nuk është shumë i përhapur.

Shëndeti dhe mirëqenja e kafshëve

Nëse ushqimi duhet të jetë i sigurtë, kafshët nga të cilat prodhohet ai ushqim duhet të jenë të shëndosha. UE konsideron me seriozitet nevojën e ruajtjes së shëndetit të kafshëve përmes përvojës së vlefshme të veterinarëve. Në të njëjtën mënyrë trajton edhe parandalojë shpërthimet e sëmundjeve të kafshëve, siç janë sëmundjet e themrave dhe të gojës, ethet e derrit, ose gripi i zogjve. Nëse shfaqet ndonjë sëmundje, ajo mbikqyret me kujdes dhe merrjen masa për ndalimin e përhapjes së saj.

Për të ndaluar inkuadrimitin e mundshëm të kafshëve të sëmura në zinxhirin ushqimor, të gjitha kafshët dhe prodhimet e kafshëve doemos duhet t'i plotësojnë kërkesat e rrepta shëndetësore para importimit ose tregëtimit në suaza të Unionit. Rregullat e UE gjithashtu kërkojnë që kafshët e fer-



UE-ja kontribuon në përmirësimin e mirëqenies së kafshëve.

mave të identifikohen, që të mund të lënë gjurmë. Për shembull, ato duhet të jenë të regjistruara, të kenë shenja ose pasaporta — varësisht nga lloji i kafshës në fjalë.

Rjeti i kompjuterizuar mundëson që autoritetet veterinarike në tërë UE të këmbëjnë informatat mbi lëvizjet e kafshëve, farët, embrionet, prodhimet dhe tepricat e kafshëve në Union.

Ekziston një parim i përcaktuar në politikën e UE – kafshët nuk duhet t'u nënshtrohen dhimbjeve ose vuajtjeve të shmangshme. Sipas hulumtimeve shkencore kafshët e fermave janë më të shëndosha dhe prodhojnë ushqim më të mirë, nëse trajtohen mirë dhe mund të sillen natyrshëm. Stresi fizik (p.sh. ruajtja, transportimi ose therja në kushte të vobekta) mund të ndikojë keq jo vetëm në shëndetin e kafshëve por edhe në kualitetin e mishit.

Gjithnjë e më tepër konsumatorë europianë brengosen për mirëqenien e kafshëve të cilat japin mish, vezë dhe prodhime të qumshtit. Kjo është pasqyruar në rregulla të qarta lidhur me kushtet ku bëhet mbarështimi i pulave, derrave dhe viçave, aty ku ato mund të transportohen dhe të vriten. Këto rregulla vazhdimisht përtrihen nga pikëpamja e të dhënave të reja shkencore.

Higjiena e ushqimit të njerëzve dhe të kafshëve

Plotësimi i standardeve të ushqimit nuk ka kuptim nëse ushqimi është prodhuar ose trajtuar në kushte johigjienike. Standardet e ulëta të higjienës ushqimore ndjellin përhapjen e bakterieve siç janë salmonela dhe listeria, të cilat shkaktojnë helmim ushqimor. Salmonela nuk ka aq publicitet sa BSE (sëmundja e lopëve të çmendura e cila përfshin sistemin qendror nervor), mirëpo është më e rrezikshme: gjindet në një varg të tërë prodhimesh ushqimore, siç janë vezët e gjalla, mishi i shpendëve, derrat dhe i lopës, dhe kështu çdo vjet vret qindra njerëz dhe infekton dhjetra mijëra të tjerë.

UE ka rregulla të veçanta që kanë të bëjnë me disa nga këto kërcnime dhe rregulla të përgjithshme të higjienës për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve, të azhuruara si pjesë e kontrollit të përgjithshëm të rregullave të sigurisë së ushqimit gjatë disa viteve të fundit. Bizneset e ushqimit duhet të identifikojnë çdo pikë në procesin e prodhimit e cila është e rëndësishme për sigurinë e ushqimit. Pas kësaj, ato duhet të zbatojnë, ruajnë dhe shqyrtojnë vazhdueshëm procedurat e tyre të sigurisë.

Për prodhuesit e vegjël, ose për ata në zonat e largëta që i shërbejnë tregjet e distancuara lokale, lejohen disa përjashtime, pasi që shpenzimet e këtyre masave mund të jenë kërcnim për mbijetimin e biznesit të tyre. Prodhuesit që janë të përjashtuar nga rregullat higjienike mund të shesin prodhimet e tyre vetëm në vend dhe vetëm nëse etiketa tregon se nuk vlejnë rregullat normale.

Vlerësimi i rrezikut: shkenca e shëndoshë për politikë moderne

Gjatë hartimit të politikës së vet të sigurisë së ushqimit dhe nivelin e pranueshëm të rrezikut, UE merr vendime të bazuara në këshilla të shëndosha shkencore dhe zhvillimet e fundit teknologjike. Komisioni Europian konsulton Komitetin e përhershëm mbi zinxhirin e ushqimit dhe shëndetit të kafshëve, në të cilin ka përfaqësues nga të gjitha shtetet e UE.

Pasi që gjithnjë e më tepër po shfaqen ushqime dhe metoda të reja prodhuese, UE vazhdimisht vlerëson dhe rivlerëson rreziqet e shkaktuara nga artikujt e ri ushqimorë. Autoriteti Europian për sigurinë e ushqimit (EFSA) i themeluar në vitin 2002 luan rol qendror në këtë proces.

Roli i EFSA-s

EFSA ka përgjegjësinë e këshillimit të institucioneve të UE-së, sidomos Komisionit Europian, mbi të gjitha aspektet shkencore të ushqimit dhe prodhimit të ushqimorë, përpunimin dhe marketingun e tij. Puna e EFSA-s përfshin një sferë të gjerë që përfshin ushqimin, organizmat e modifikuar gjenetikë, shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mirëqenien e bimëve. EFSA u ofron vendim-marrësve të UE-së këshilla shkencore, në mënyrë më efektive dhe transparente se në të kaluarën.



Testimi është pjesë vitale në prodhimtarinë e ushqimit të sigurtë.

Pasi që EFSA të ketë dhënë këshillën shkencore, kryesisht i mbetet Komisionit Europian të vendosë se në ç'mënyrë do të përgjigjet. Qeveritë e UE dhe Parlamenti Europian i kanë dhënë Komisionit autoritetin e ndërmarrjes së veprimit të drejtpërdrejtë, në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë. Komisioni mundet, për shembull, në këto rrethana të imponojë kushtet e nxjerrjes së ushqimit në treg. Ai mund të kufizojë ose madje edhe ta ndalojë shitjen e ushqimit në fjalë. Këto vendime dhe disa të tjera operative diskutohen me shtetet anëtare në takimet e Komitetit të përhershëm mbi zinxhirin ushqimor dhe shëndetin e kafshëve.

Trajtimi i kujdesshëm i prodhimeve të modifikuara gjenetiksht (GMO)

Vlerësimi i kujdesshëm i rrezikut mund të shihet në mënyrën se si UE i qaset bioteknologjisë. Shumë pak *GMO* ose prodhime me origjinë nga organizmat e modifikuar gjenetiksht janë autorizuar në UE, dhe secili prej tyre ka kaluar një proces të kujdesshëm të vlerësimit individual të shkencëtarëve të pavarur, që tani përfshijnë shkencëtarët që punojnë me *EFSA*. Këta shkencëtarë kanë konkluduar se *GMO* dhe prodhimet e tyre nuk kanë asnjë efekt që konsiderohet si negativ mbi shëndetin e njeriut.

Parimi i parandalimit

Para miratimit të politikës që vendos sigurinë e konsumimit të një produkti ushqimor, apo lejimin e ndonjë përbërësi ose shtuesi të veçantë, UE konsulton këshillat shkencore. Në **menaxhimin** e rrezikut, UE zbaton 'parimin parandalues': nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar ekzistencën e ndonjë problemi, Komisioni vepron për të izoluar rrezikun dhe nuk është e domosdoshme të ketë dëshmi për ekzistimin e rrezikut.

Natyrisht, ky parim nuk guxon të përdoret gabimisht si arsyetim për masa proteksioniste. Aty ku shkencëtarët nuk kanë vërtetuar përfundimisht natyrën e rrezikut, ata duhet të kenë identifikuar së paku efektet potenciale të rrezikut para përdorimit të arsytuar të parimit parandalues nga ana e Komisionit, për të marrë masa lidhur me prodhimet ushqimore.

Të gjitha veprimet që i merr Komisioni duhet të kenë për qëllim vetëm rrezikun potencial. Këto veprime duhet të jenë jodiskriminuese — me fjalë të tjera, duhet të ndikojnë te të gjithë prodhuesit në mënyrë të barabartë. Këto veprime duhen bazuar në kontrollin e shpenzimeve dhe beneficioneve që vijnë nga ato. Duhet të jenë gjithashtu veprime të përkohshme deri në momentin e arritjes së sigurisë së lartë shkencore.

Para fillimit të çdo lloj hulumtimi shkencor është i nevojshëm miratim, gjë që vlen edhe para dhënies së lejes së përdorimit të ushqimit gjenetikiisht të modifikuar në treg. Rregullat e njejta vlejnë si për ushqimin e njerëzve ashtu edhe për atë të kafshëve. Autorizimet kanë afat 10 vjeçar. Procedurat e prera që janë involvuar, përfshijnë konsultimin e gjërë publik.

Ushqimi, përbërësit e ushqimit dhe etiketat e ushqimit të kafshëve duhet të dëshmojnë nëse produkti ka origjinë ose përbëhet prej materialit gjenetikiisht të modifikuar madje edhe kur përdorimi i teknologjisë nuk mund të zbulohet në prodhimin

përfundimtar, si për shembull në disa vajëra për përdorim shtëpiak.

Përrjashtimi i vetëm i rregullës 'etiketa e domosdoshme' është vetëm atëherë kur ekziston gjurmë nga materiali gjenetikiisht i modifikuar, që konsiderohet të jetë përbërje nën nivelin e pragut minimal. Këto pragje pranojnë realitetin me të cilin duhet të punojë politika: është praktikisht e pamundur që të gjitha llojet e prodhimeve të mos kenë përqindjen më të vogël të materialit gjenetikiisht të modifikuar. Zbulimi i *GMO* ose prodhimeve të modifikuara gjenetikiisht, mund të përdoret në ushqimin konvencional gjatë kultivimit, korjes, transportit ose përpunimit.



Siguria e ushqimit fillon nga fermat.



Ushqimi i foshnjeve duhet të jetë veçanërisht i sigurtë.

Financimi i punës kërkimore mbi sigurinë e ushqimit

Në interes të shkencës së shëndoshë, UE shpenzon dhjetra milionë euro në vjet, për gjetjen e mënyrave të reja të mbrojtjes ose zbulimit të hershëm dhe të shpejtë të shfaqjes së sëmundjeve të kafshëve, dhe punë për drithërat e reja dhe më të mira. Ekziston një buxhet 685 milionë €, vetëm për hulumtimin shkencor të kualitetit dhe sigurisë së ushqimit në periudhën prej 2002 deri në 2006.

Këto fonde kryesisht shpenzohen për të shqyrtuar:

- kur dhe ku shfaqen më së tepërmi sëmundjet dhe alergjitë që kanë të bëjnë me ushqimin,
- relacioni midis ushqimit dhe shëndetit,

- mbikqyrja e zinxhirit ushqimor,
- metodat e analizës,
- zbulimi dhe kontrollimi i kërcenimeve të sigurisë së ushqimit,
- metodat dhe teknologjitë më të sigurta të prodhimit,
- artikujt më të shëndoshë ushqimorë,
- mënyra në të cilën ushqimi i kafshëve mund të ndikojë përfundimisht në shëndetin e njerëzve, dhe
- roli i faktorëve të mjedisit mbi shëndetin.

Mbrojtja e konsumatorëve: zbatimi dhe kontrolli

Duke filluar nga viti 1990, UE ka kontrolluar hollësisht elementin e tretë të strategjisë së vet të sigurisë së ushqimit — sistemi i garantimit të harmonizimit të ligjeve të sigurisë së ushqimit. Ndryshimet janë dëshnuar për qartësimin e detyrave – kush çka bën – dhe me këto ndryshime konsumatorëve u ofrohet niveli i njejtë i mbrojtjes kudo që jetojnë ata.

Ka pasur një zhvendosje të përqëndrimit larg nga ai që është zakonshëm, por rastësisht është zgjedhur t'u kushtohet vëmendje burimeve të rrezikut më të madh. Rreziqet mund të jenë të mëdha për shkak të sasisë së madhe të shitjes së një prodhimi të caktuar, ose për shkak të prirjes së prodhimit të caktuar ndaj sëmundjes nga ndonjë bimë ose sëmundje e caktuar e kafshëve.

UE gjithashtu ka qëndrim të hapur kur bëhet fjalë për domethënien e sigurisë së ushqimit. Në vend të përqëndrohet vetëm në kontrollin e kontaminimit, autoritetet e UE tani kanë zgjeruar fushëveprimin e kontrollit të

tyre më sistematik ku vlerësojnë përputhshmërinë e produkteve me kërkesat informative të konsumatorëve dhe me rregullat e elementeve përbërëse të artikujve ushqimorë.

Zyra e ushqimit dhe veterinarisë (FVO), e cila paraqet një përforsim të Komisionit Europian me seli në Grange në Irlandë, luan rol të rëndësishëm në përpjekjen e vërtetimit të zbatimit të rregullave. Ekipi i kësaj zyre me rreth 100 inspektorë udhëton kryq e tërthor UE dhe në mbarë botën për të kontrolluar ekzistimin e kontrollit adekuat dhe zbatimin e mekanizmave. Si pjesë e këtyre inspektimeve janë vizitat që inspektorët ua bëjnë prodhuesve ose fabrikave të përpunimit, ku vërtetojnë efektivitetin e këtyre mekanizmave dhe përdorimin e tyre praktik. Nëse ka nevojë, zyra e ushqimit dhe veterinarisë dërgon inspektorët e vet si reagim në rastet e shfaqjes së sëmundjeve përbrenda dhe jashtë UE.

Sistemi i shpejtë alarmues

Sistemi i shpejtë alarmues për ushqimin e njerëzve dhe kafshëve (RASFF) mundëson informata të shpejta për konsumatorët mbi rreziqet e posa identifikuara. Nëse një qeveri e UE shquan ndonjë artikull ushqimor që mendon se mund të paraqesë rrezik për konsumatorin, kjo qeveri e përdor këtë rrjet për të përhapur informatat mbi rrezikun potencial dhe aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë për të ndaluar hyrjen e këtij artikulli në zinxhirin ushqimor. Me këtë, rreziku shumë shpejtë fiton publicitet në tërë Europën dhe autoritetet e shteteve të tjera anëtare kanë të drejtë të veprojnë shpejt nëse mendojnë që qytetarët e tyre janë gjithashtu të rrezikuar.

Deri më tani është alarmuar për arsye të ndryshme, duke filluar nga zbulimi i salmonelës në mish e deri te përdorimi i ngjyrosjeve të dëmshme të erëzave, dhe prej zhivës te peshqit e deri te importimi i ushqimeve nga fabrikat e paautorizuara të përpunimit. Komisioni Europian është nyje e një rrjeti që përfshin autoritetet nacionale dhe EFSA. Informatat mbi vigjilencën publikohen në Internet.

Informimi i vazhdueshëm i konsumatorëve: etiketa pasqyron sigurinë

Njerëzit duan dhe kanë të drejtë të dijnë se çka konsumojnë. Rregullat e etiketimit të ushqimit e pohojnë këtë të drejtë. Parimi fundamental i rregullave të UE për etiketimin e ushqimit është se konsumatorët duhet të marrin të gjitha informatat mbi përbërjen e prodhimit, prodhuesin, metodat e magazinimit dhe përgatitjen. Prodhuesit dhe fabrikantët kanë lirinë e ofrimit të informatave plotësuese, mirëpo këto informata duhet të jenë të sakta, të mos mashtrjnë konsumatorët dhe të mos deklarojnë se artikujt ushqimorë mund të parandalojnë, trajtojnë ose shërojnë sëmundje të caktuara.

Kërkesat e etiketimit vazhdimisht plotësohen për të pasqyruar avancimin e shkencës dhe ndryshojnë pritjet e konsumatorëve. Ndryshimet e fundit pasqyrojnë brengën publike për *BSE* (sëmundja e 'lopëve të çmendura'): konsumatorët dëshirojnë të gjitha informatat maksimale lidhur me mishin e lopës që e blejnë. Etiketat e mishit të lopës tani duhet të shënojnë ku është lindur kafsha, ku është mbarështuar, ku është majur, therrur dhe ku është prerë.



Informatat e qarta janë jashtë-zakonisht të rëndësishme për konsumatorët.

Konsumatorët gjithashtu duan të informohen nëse ushqimi përmban ndonjë prodhim të modifikuar gjenetikisht dhe të shohin nga etiketa nëse ndonjë përbërës ushqimor mund të shkaktojë ndonjë alergji — këto janë arsye plotësuese për ndryshimet e fundit. Nëse një ushqim përmban një prodhim të modifikuar gjenetikisht, ose nëse një prodhim me origjinë të materialit të modifikuar gjenetikisht ka qenë i involvuar në prodhimin e tij, atëherë etiketa doemos duhet ta përmbajë atë informatë.

Rregulla të veçanta zbatohen për artikuj të caktuar ushqimorë. Për shembull, prezenca e kininës dhe kofeinës në ushqim duhet gjithashtu të shënohet qartë.

Sfida e disajnit të rregullave bashkëkohore të etiketimit të ushqimit është balancimi mes informimit sa më të madh të konsumatorëve dhe shmangia e mbingarkimit të etiketës me informata që vështirësojnë leximin dhe kuptimin.

Kuptimi i kërkesave ushqimore

UE pohon se konsumatorët duan ushqim të sigurtë dhe njëkohësisht kërkojnë që i njejtë të ketë vlera ushqyese. Për më tepër, vlerat e dobishme ushqyese janë gjithnjë e më të rëndësishme për politikën e shëndetit publik të UE. Numri i njerëzve të trashë po shtohet dhe diëta e shëndetshme është element i rëndësishëm në ndryshimin e këtij trendi. UE nuk pretendon mikromenaxhimin e ushqimit që përdorin njerëzit ose imponimin e stilit të tyre të jetës, mirëpo ndihmon publikun evropian në marrjen e vendimeve bazuar në informatat që i ofron vet UE dhe garanton besueshmërinë dhe mbështetjen shkencore të kërkesave.

Puna e Komisionit Evropian në këtë fushë përfshin definimin e kërkesave të pranueshme ushqyese (siç është përdorimi i termeve 'përqindje e ulët e yndyrës' ose 'me përqindje të lartë të fijeve') dhe themelimin e sistemit autorizues të kërkesave ushqimore.

Mbrojtja nga alergjitë dhe jotoleranca ndaj ushqimit

Proporcioni i popullatës që vuan nga alergjia ose jotoleranca e ushqimit (kikiriku ose laktoza, për shembull) po shtohet gjithnjë e më tepër. Diku rreth 8% fëmijë dhe 3% të rritur tani vuajnë nga alergjia ose mospranimi i ushqimit. Etiketimi i klasifikuar ndihmon që kjo përqindje e njerëzve të shmangë përdorimin e artikujve ushqimorë ose përbërësve që provokojnë reagime. Në të kaluarën, nuk ka qenë e detyrueshme të shënohen përbërësit që përbëjnë më pak se 25% të prodhimit përfundimtar. Nga viti 2005, doemos duhet të regjistrohen të gjithë përbërësit. Mund të ekzistojë numër i kufizuar i përjashtimeve nga ky rregull, mirëpo një përbërës i cili njihet si burim potencial i alergjisë ose mospranimit duhet të shënohet.

Reforma e qasjes së UE ndaj bujqësisë

Politika e përbashkët bujqësore (CAP) gjithnjë është munduar të garantojë sigurinë e ushqimit tonë. Mirëpo, gjatë viteve të para, theks i veçantë i kushtohej sigurimit të ushqimit të mjaftueshëm për UE, qoftë në vitet produktive e qoftë në ato joproduktive.

Kjo politikë kishte për qëllim gjithashtu ofrimin e të ardhurave të rregullta për bujqit me garancën se tregu për prodhimet e tyre do të ekzistojë gjithnjë, madje edhe nëse kjo nënkuptonte blerjen dhe magazinimin e tepricave eventuale. Me kalimin e viteve, kjo qasje u bë jashtëzakonisht e shtrenjtë, me atë që prodhonte 'lumenj' të qumështit dhe verës së tepërt, dhe 'male' të mishit të viçit dhe gjalpës së tepërt, të cilat bliheshin, magazinoheshin dhe në një mënyre ishin barrë e llogarisë së UE.

Një nga mënyrat që UE t'i hiqte qafe këto teprica ishte eksportimi i tyre me çmime të subvencionuara, që të mund të shiten me çmim (më të ulët) të tregut botëror. Shumë shtete kryesisht eksportuese konsideronin se kjo konkurrencë nuk ishte e drejtë dhe paraqiste shtrembërimin e tregëtisë botërore.

Për të marrë parasysh këto shtypje dhe shpenzimet e zgjerimit të UE, u prezantuan një sërë reformash. Parimet dhe limitet afatgjate shpenzuese u radhitën në dokumentin e quajtur 'Agjenda 2000'. Një pako e rëndësishme e reformave u miratua edhe në vitin 2003. Subvencionet eksportuese janë duke u zvogëluar.

Efekti i përgjithshëm është që bujqit e UE të jenë të besueshëm në treg dhe të fitojnë subvencionime më të mëdha për bujqësi dhe blegtori në mjedis të favorshëm. Bujqit tani kanë më tepër liri në prodhimin e gjërave që dëshirojnë, pasi që ndihma financiare që e pranojnë nuk është e lidhur me prodhimtarinë por me respektimin e standardeve të mjedisit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe me nevojat individuale financiare.

Agjenda 2000 ishte një kthesë tjetër në ndërtimin e zhvillimit rural si pjesë përbërëse e politikës bujqësore. Në të ardhmen, buxheti i Politikës së përbashkët të bujqësisë gjithnjë e më tepër do të përdoret të ndihmojë qëndrueshmërinë e mënyrës rurale të jetës – për shembull, duke krijuar vende të punës në zonat rurale dhe mirëmbajtjen e tyre që njerëzit të mund ta shijojnë jetën në fshat.

Siguria e ushqimit fillon në fermat tona

Në UE ka mbi se 10 milionë bujq. Ky numër përfaqëson 5.4 % të të gjitha punësimeve. Bujqësia krijon shumë vende të reja pune për komunitetet në afërsi sidomos në përpunimin e ushqimit të njerëzve dhe kafshëve. Një pjesë e madhe e ushqimit që e konsumojmë vjen nga fermat e UE-së.

Si reagim i mungesës së ushqimit dhe pas Luftës së dytë botërore, Politika e përbashkët bujqësore (CAP) e UE fillimisht inkurajonte prodhimin e bollshëm të ushqimit, për të plotësuar nevojat. Përgjithësisht thënë, sa më tepër prodhonin bujqit aq më tepër pranonin ndihmë financiare. Me kalimin e kohës, kjo politikë krijoi

tepricë me shpenzime të mëdha për pagesit e tatimeve dhe ndonjëherë kishte efektin e kanalizimit të ndihmës financiare në duart e bujqëve të cilët nuk kishin nevojë për atë.

Identifikimi i këtij problemi koinçidonte me brengat gjithnjë e më të mëdha nëse Politika e përbashkët bujqësore (CAP) do të inkurajonte metodat intensive të bujqësisë, të cilat shtonin rreziqet e sigurisë së ushqimit. Kjo nxiti reformën e CAP, e cila po largohet nga pagesa e prodhimit për t'u orientuar drejt pagesës direkte që mbështet të ardhurat e bujqve.

Komunitet e begatshme rurale janë të rëndësishme.





Koha po ndryshon për bujqit e Europës.

Përparësia plotësuese e kësaj qasjeje është se pagesat mund të stimulojnë bujqit në:

- prodhimin e ushqimit të sigurtë në kushte higjienike,
- ruajtjen e standardeve të larta të mirëqenies së kafshëve,
- përdorimin e metodave të shëndosha ambientale të prodhimit, dhe
- promovimin e ekonomisë së qëndrueshme rurale.

Kjo qasje e re konsiderohet si mjete më i mirë i kombinimit të disa objektivave:

- të ardhurat e arsyeshme për bujqit,
- çmimet e favorshme dhe ushqimi i sigurtë i kualitetit të lartë për konsumatorët,

- shpenzimet e pranueshme për tak-sapaguesit
- mundësimi i qasjes së shteteve të tjera në tregjet e UE për plasimin e produkteve dhe ushqimit të tyre,
- industria konkurruese e ushqimit.

UE tani i kushton më tepër vëmendje kualitetit për dallim nga kuantiteti dhe thekson rolin dhe të ardhurat e bujqve individualë. Për shembull, UE ofron ndihmë për bujqit që marrin pjesë në skemat e disejuara për përmirësimin dhe sigurimin e kualitetit të prodhimeve bujqësore dhe proceseve të prodhimit.

Ushqimi i sigurtë nga mbarë bota

UE është importuesi më i madh botëror i ushqimit dhe tregu më i madh për importimin e ushqimit nga shtetet në zhvillim. Unioni importon ushqim, bimë dhe kafshë nga mbi se 200 shtete. Fermat dhe prodhuesit ushqimorë në vendet që nuk janë anëtare të UE, e të cilat eksportojnë në UE doemos duhet t'i respektojnë parimet e njejta të sigurisë të cilat zbatohen në UE. Në kufijtë e UE bëhen kontrole për ndalimin e hyrjes së ushqimit të pasigurtë përbrenda kufijve të UE.

Ndonjëherë, Unionin European e akuzojnë për standardet jashtëzakonisht të larta të ushqimit, të cilat i shërbejnë si mjet për shmangien e importimit. Kjo akuzë nuk është e vërtetë: UE ka zgjedhur alternativën politike për të mos bërë compromise mbi rregullat e sigurisë së ushqimit. Ky vendim vlen për shtetet anëtare të UE, por edhe për të gjitha shtetet e tjera që duan të eksportojnë në UE. Siguria e ushqimit fillon nga fermat nga të cilat vjen ushqimi.

Krahas kësaj, UE bashkëpunon me shtetet tjera në organizatat ndërkombëtare mbi hartimin e rregullave adekuate të sigurisë së ushqimit, pasi që zgjidhja më e drejtë është harmonizimi i të gjitha standardeve në tërë botën. Kjo lehtëson situatën e shteteve që eksportojnë në UE, sidomos për industrinë ushqimore të UE, e cila eksportohet në pjesën tjetër të botës. Në këtë bashkëpunim, UE çdo herë insiston për standardet më të larta të mundshme, jo vetëm për sigurinë e ushqimit, por gjithashtu për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin rural, prodhimtarinë e qëndrueshme dhe mirëqenien e kafshëve.

UE konsideron se plotësimi i këtyre standardeve mund të jetë i vështirë

dhe i shtrenjtë për shtetet në zhvillim, kështu që ofron ndihmë teknike për t'u ndihmuar atyre të plotësojnë standardet e veta. Kjo ndihmë, në mënyrë indirekte sjell beneficione për shtetet në fjalë me atë që përmirësimi i standardeve të veta të ushqimit dhe shëndetit zvogëlon numrin e vdekjeve nga ushqimi dhe uji i kontaminuar. Në shtetet në zhvillim, rreth dy milionë fëmijë vdesin nga këto shkaqe çdo vjet.

UE gjithashtu kontribuon në kampanjat e ngritjes së vetëdijes për inkurajimin e konsumatorëve të UE të blejnë prodhime 'të tregut të lirë'—me fjalë të tjera artikuj të shëndoshë ushqimorë por krahas kësaj artikuj ushqimorë nga prodhuesit që janë paguar me çmim të favorshëm dhe prodhime që janë trajtuar dhe përpunuar nga punëtorë të cilët janë trajtuar në mënyrë të drejtë.

Këto gaforre do të jenë kontrolluar me kujdes, para eksportimit në UE.



© Tom Stuart/Van Parys Media

Përtej sigurisë: kualiteti dhe shumllojshmëria

Konsumatorët e UE duan ushqim të sigurtë, por edhe të kualitetshëm. Përveç kësaj, ata duan që UE të respektojë kulturën dhe kuzhinat e llojllojshme përbrenda kufijve të vet. UE e respekton këtë fakt dhe ka promovuar katër “marka për kualitet”.

Shenjat dalluese për **mbrojtje të origjinës (protected designations of origin - PDO)** dhe **mbrojtje të shenjave gjeografike (protected geographical indications - PGI)** vlejnjë për prodhimet bujqësore ose ushqimore të cilat janë ngushtë të lidhura me një vend apo rajon të caktuar.



Kur produkti mban markën PGI, atëherë ka tipar dallues ose famë që e lidh atë me një rajon të caktuar dhe së paku një fazë e procesit të prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes rodhimit të tij është realizuar në atë rajon. Shembuj të këtyllë janë “Clare Island Salmon”, “Arancia Rossa di Sicilia” dhe “Dortmunder Bier”. Kjo nënkupton se produktet e vetme ushqimore që mund të përdorin këto emra janë salmoni nga ishulli Clare në Irlandë, portokallat e kuq nga Sicilia dhe birra e rajonit të Dortmundit në Gjermani, pasi që i përmbushin kushtet e caktuara për kualitet.



Prodhimi që mban shenjen dalluese **PDO** ka karakteristika të testuara të cilat janë vetëm rezultat i mjedisit natyror dhe aftësia e prodhuesve të rajonit ku prodhohet dhe me të cilët është i lidhur.



Shenja dalluese për **specialitet të garantuar tradicional (traditional speciality guaranteed - TSG)** përdoret për prodhime me karakteristika të veçanta, të cilat kanë përbërës tradicionalë ose prodhohen duke përdorur metoda tradicionale. Prodhimet që bëjnë pjesë në këtë grup janë: buka “Kalakukko”, birrat “Jamón Serrano” dhe “Kriek”. Këto produkte janë të regjistruara në Finlandë, Spanjë dhe Belgjikë.



Marka për **origjinë organike (organic farming)** nënkupton se prodhimet ushqimore janë prodhuar me përdorimin e metodave të miratuara organike, të cilat e respektojnë mjedisin jetësor dhe standardet e larta të mbrojtjes së kafshëve. Bujqit i shmangen përdorimit të pesticideve sintetike dhe plehrave kimike.

Baza e shëndoshë për laramani dhe cilësi të shkëlqyer

Siguria e ushqimit ka të bëjë me minimizimin e rrezikut. Unioni me seriozitet konsideron përgjegjësinë e vet mbi menaxhimin dhe kontrollimin e rrezikut në tregun global të ushqimit, i cili vazhdimisht po ndryshohet. Unioni merr vendime të bazuara në shkencë të shëndoshë, e cila është transparente për të gjithë, qofshin ata shkencëtarë, bujq, prodhues ushqimorë apo konsumatorë.

UE konsideron se standardet e sigurisë së ushqimit, duhet të mos kufizojnë dhe të promovojnë zgjidhjet dhe kualitetin. Nuk është qëllimi të frenohen inovacionet ose të

homogjenizohet koleksioni i gjerë i artikujve ushqimorë që mund të blehen në tregun evropian, por të caktohen standardet fundamentale të sigurisë, të cilat do të shërbejnë si bazë mbi të cilat do të mund të kultivohet dhe lulëzojë kualiteti dhe përsosmëria.

Reziku asnjëherë nuk mund të eliminohet plotësisht. Mirëpo, me përcaktimin e standardeve të larta, me vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut dhe me shfrytëzimin e këshillave të pavarura shkencore, UE do të mund të mburret me politikën e vet moderne të sigurisë së ushqimit.



UE-ja e zgjeruar nënkupton shumëllojshmëri më të madhe por me standarde të larta.

Literaturë plotësuese



Dokumenti mbi sigurinë e ushqimit:

europa.eu.int/comm/dgs/health_consumer/library/pub/pub06_en.pdf

Zëri i konsumatorëve (revistë mbi politikën e konsumatorit në UE):

europa.eu.int/comm/dgs/health_consumer/library/pub/index_en.html

Web faqja e Komisionit European mbi sigurinë e ushqimit:

europa.eu.int/comm/food/index_en.html

Web faqja e Komisionit European mbi bujqësinë dhe ushqimin:

europa.eu.int/comm/agriculture/foodqual/index_en.htm

Web faqja e Autoritetit European për sigurinë e ushqimit:

efsa.eu.int

Web faqja e sistemit të shpejtë alarmues për ushqim të njerëzve dhe kafshëve:

europa.eu.int/comm/food/food/rapidalert/index_en.htm

Komisioni Europian

**Nga ferma deri në tryezë
Ushqim i sigurtë për konsumatorët e Europës**

Edicioni – Europa në lëvizje

Luksemburg: Zyra e botimeve zyrtare të Komunitetit Europian, 2004

ISBN 978-92-79-04819-7

Siguria e ushqimit është prioritet numër një në Europë. Rregullat e UE janë ashpërsuar edhe më tepër që nga viti 2000 për të garantuar sigurinë e ushqimit të europianëve në shkallën më të lartë. Qasja e re është më e integruar: ushqimi ndiqet me vëmendje nga ferma deri në tryezë. Autoritetet e UE vlerësojnë rrezikun me kujdes dhe çdo herë kërkojnë këshillën më të mirë të mundshme shkencore para ndalimit ose lejitimit të prodhimeve, substancave, përbërësve, shtesave ose organizmave gjenetikisht të modifikuar (*GMO*). Kjo vlen për të gjitha ushqimet e njerëzve dhe të kafshëve, pavarësisht nëse janë nga brenda ose jashtë UE.

Siguria nuk nënkupton njëtrajtshmëri. UE promovon llojllojshmërinë e bazuar në kualitet. Ligji europian mbron ushqimet dhe prodhimet tradicionale nga rajonet e veçanta, me atë që konsumatorët mund t'i dallojnë ato nga falsifikatet. Unioni Europian gjithnjë e më tepër po inkurajon bujqit e vet të fokusohen në kualitet — jo vetëm të ushqimit por gjithashtu edhe të mjedisit rural.

UE gjithashtu respekton të drejtën e konsumatorit të informohet mirë para se të bëjë zgjedhjen e produkteve. Unioni inkurajon debate publike, kërkon përdorimin e etiketave me informata dhe boton këshillat shkencore, në mënyrë që konsumatorët të kenë besim në ushqimin që e konsumojnë.

Informata të tjera mbi Unionin European



Hapeni internetin

Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit European mund t'i gjeni në faqen e internetit Europa: europa.eu



Ejani dhe na vizitoni

Në Europë ka disa qendra informative të UE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni përmes faqes: europa.eu.int/comm./relays/index_en.htm



Paraqituni ose na shkruani

EUROPE DIRECT është shërbim që përgjigjet në pyetjet tuaja mbi Unionin European. Këtë shërbim mund ta kontaktoni përmes telefonit pa pagesë: 00 800 6 7 8 9 10 11, (telefoni me pagesë në raste të thirrjeve jashtë UE-së: (32-2) 29-99696), ose me anë të postës elektronike europedirect.europa.eu

Informata dhe broshura mbi UE në anglisht, maqedonisht dhe shqip mund të merrni në adresat vijuese:

Qendra informative e Unionit European

Marshal Tito, 12
1000 Shkup
Tel. 02/3248-531
Faks. 02/3248-501
Internet: www.delmkd.cec.eu.int
E-mail: delegation-fyrmacedonia-info@ec.europa.eu

Pika informative e UE në Gostivar

Braqa Ginovski 61
1230 Gostivar
Tel. 042/218-167
Faks. 042/218-167
E-mail: gostivar@cig.org.mk

Pika informative e UE në Koçani

Rade Kratovce 1
2300 Koçani
Tel. 033/274-045
Faks. 033/279-962
E-mail: info@kocani.gov.mk

Pika informative e UE në Kumanovë

11 Oktomvri bb
1300 Kumanovë
Tel. 031/432-650
Faks. 031/432-650
E-mail: kumanovo@cig.org.mk

Pika informative e UE në Veles

Panko Brashnar 1
1400 Veles
Tel. 043/232-406; lok. 226
Faks. 043/232-966
E-mail: veles@cig.org.mk

Pika informative e UE në Kavadarc

Marshal Tito bb
1430 Kavadarc
Tel. 043/416-107
Faks. 043/416-107
E-mail: opka@mt.net.mk

Pika informative e UE në Manastir

1 Maj bb
7000 Manastir
Tel. 047/232-800
Faks. 047/232-800
E-mail: bitola@cig.org.mk

Pika informative e UE në Tetovë

JNA bb
1200 Tetovë
Tel. 044/333-910
Faks. 044/333-910
E-mail: info@tetovo.gov.mk

Qendra europiane e dokumentimit

Fakulteti ekonomik, Univerziteti "Shën Kirili dhe Metodi"
Krste Misirkov bb
1000 Shkup
Tel. 02/3286-835
Faks. 02/3118-701
Internet: www.eccf.ukim.edu.mk
E-mail: valentina@eccf.ukim.edu.mk

Përfaqësitë dhe zyrat e Komisionit dhe Parlamentit European ndodhen në të gjitha shtetet e Unionit European. Komisioni European ka Delegacione edhe në pjesë të tjera të botës.

Unioni European



 Shtetet anëtare të UE-së
 Shtetet kandidatë



Siguria e ushqimit është prioritet numër një në Europë. Rregullat e UE janë ashpërsuar edhe më tepër që nga viti 2000 për të garantuar sigurinë e ushqimit të europianëve në shkallën më të lartë. Qasja e re është më e integruar: ushqimi ndiqet me vëmendje nga ferma deri në tryezë. Autoritetet e UE vlerësojnë rrezikun me kujdes dhe çdo herë kërkojnë këshillën më të mirë të mundshme shkencore para ndalimit ose lejimit të prodhimeve, substancave, përbërësve, shtesave ose organizmave gjenetikisht të modifikuar (GMO). Kjo vlen për të gjitha ushqimet e njerëzve dhe të kafshëve, pavarësisht nëse janë nga brenda ose jashtë UE.

Siguria nuk nënkupton njëtrajtshmëri. UE promovon llojllojshmërinë e bazuar në kualitet. Ligji europian mbron ushqimet dhe prodhimet tradicionale nga rajonet e veçanta, me atë që konsumatorët mund t'i dallojnë ato nga falsifikatet. Unioni Europian gjithnjë e më tepër po inkurajon bujqit e vet të fokusohen në kualitet — jo vetëm të ushqimit por gjithashtu edhe të mjedisit rural.

UE gjithashtu respekton të drejtën e konsumatorit të informohet mirë para se të bëjë zgjedhjen e produkteve. Unioni inkurajon debate publike, kërkon përdorimin e etiketave me informata dhe boton këshillat shkencore, në mënyrë që konsumatorët të kenë besim në ushqimin që e konsumojnë.